



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË - MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE - MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY	
Nr. Prot. Org. Jedinica Org. Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	5029
Nr. Faqeve Broj Stranica Number of Pages	3
Data Datum Date	13.07.2018

Republika e Kosovës
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry
Kabineti i Ministrimit - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister

01.Ref. Nr.36
Prishtinë, 13.07.2018

Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 Për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, nenit 19 të Ligjit Nr. 04/L-047 Për Masat Mbrojtëse në Importe, si dhe nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 8 të Rregullores Nr. 02/2011 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive merr:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Departamentit të Tregtisë / Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e masës së përkohshme mbrojtëse në importin e pemëve dhe perimeve të vlerës doganore prej 30 % në Republikën e Kosovës.
2. Pjese përbërëse e këtij vendimi është shtojca Nr. 1 - Llojet e produkteve bujqësore të cilat do të mbrohen sipas paragrafit 1 të këtij vendimi.
3. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Dogana e Kosovës nga data 18.07.2018.
4. Ky vendim hyn në fuqi nga data 18.07.2018.

Arsyetimi

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka lëshuar njoftimin për iniciimin e hetimit për importet e pemëve dhe perimeve me origjinë nga të gjitha vendet e botës, siç parashikohet në paragrafin 3 të nenit 7 të Ligjit Nr.04 / L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe.

Njoftimi erdhi pas vlerësimit paraprak të gjendjes; përfshirë konsultimet me prodhuesit siç parashihet në paragrafin 1 të nenit 6 të Ligjit Nr.04 / L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe. Vlerësimi ofroi bazë të mjaftueshme për të përcaktuar se produktet që do hetohen, importohen në Republikën e Kosovës në sasi aq të mëdha dhe në ato kushte të cilat kërcënojnë t'u shkaktojnë dëm serioz prodhuesve të pemëve dhe perimeve në vend ose të



shkaktojnë parregullsi që mund të përkeqësojnë gjendjen ekonomike të prodhuesve të pemëve dhe perimeve në Republikën e Kosovës.

Nga kjo u vendos si ne dispozitiv të këtij vendimi.



Bajram HASANI

Ministër i MTI-së

Vendimi i dërgohet:

- *Doganës të Kosovës;*
- *Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MTI-së;*
- *Departamentit të Tregtisë;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Arkivit të MTI-së.*



Shtojca Nr. 1

Tabela 1: Llojet e produkteve bujqësore.

1.	<i>Patatja</i>
2.	<i>Domatja</i>
3.	<i>Speci</i>
4.	<i>Trangulli</i>
5.	<i>Shalqiri</i>
6.	<i>Pjepëri</i>
7.	<i>Lakra e hershme (pranverore)</i>
8.	<i>Lakra e vonshme (vjeshitore)</i>
9.	<i>Sallatë (të gjitha varietetet)</i>
10.	<i>Spinaqi</i>
11.	<i>Qepa</i>
12.	<i>Karrota</i>
13.	<i>Fasulja monokulture</i>
14.	<i>Molla</i>
15.	<i>Dardha</i>
16.	<i>Kumbulla</i>
17.	<i>Qershia</i>
18.	<i>Dredhëza</i>
19.	<i>Mjedra</i>
20.	<i>Manaferra</i>
21.	<i>Misri</i>

